

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Driton Muharremi, kryetar, Have Haliti dhe Abdullah Ahmeti anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Arta Dumani, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit E.K. nga fsh. ... Komuna e Drenasit, për shkak të veprës penale marrje e ryshfetit nga neni 428 par. 2 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore DKR në Prizren dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit av. N.Q., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DKR në Prizren, P.nr.192/16 të dt. 19.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 par.4 të KPPK, me datë 21.09.2017 mori këtë :

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit E.K., dhe sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prizren, P.nr.192/16 të dt. 19.05.2017, ndryshohet përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që Gjykata e Apelit gjënë se në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitivit të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK, si dhe i hiqet masa e ndalimit të ushtrimit të profesionit në kohëzgjatje prej dy vjet, konformë nenit 65 par. 2 të KPRK-së.

II. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit në bazat tjera ankimore refuzohen , si të pa bazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar për pjesën tjetër vërtetohet .

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda P.nr.192/16 të dt. 19.05.2017, i akuzuari E.K., është shpallur fajtor, për veprën penale marrje e ryshfetit nga neni 428 par. 2 të KPK, është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej 2.500 (dy mije e pesëqind) €, të cilën gjobë i akuzuari është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € të gjobës do t'i caktohet një ditë burgim.

Të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës së policit në Policinë e Kosovës, në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, duke i llogaritur prej datës kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarit i është konfiskuar kartëmonedha prej 50 (pesëdhjetë) €.

Është obliguar i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse në emër paushallit gjyqësorë, të paguajë shumën prej 100 €, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë paraqitur.

Prokuroria Themelore DKR në Prizren, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë me burgim.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.K., av. N.Q., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit penal dhe vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose i akuzuari të lirohet nga akuza.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.344/17 të datës 20.07.2017, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar, ankesa e Prokurorisë Themelore- DKR në Prizren, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i lartë, ndërsa ankesa e mbrojtësit akuzuarit, av. N.Q., të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK, mbajti seancën e kolegjit, në të cilën kanë prezantuar: i akuzuari E.Q. dhe mbrojtësi i tij, av. N.Q., ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit edhe pse ishte njoftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të akuzuarit dhe të mbrojtësit të akuzuarit, pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit E.K., janë të pabazuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë pretendon, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par. 4, 7 dhe 8 të KPK-së. Dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, arsyet e dhëna janë të paqarta dhe kundërthënëse, ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit me përmbajtjen e shkresave të lëndës. Gjykata e shkallës së parë, ka dështuar të arsyetojë faktet vendimtare që kanë të bëjnë me faktin se në cilën datë dhe çfarë kohe pretendohet se ka ndodhur ngjarja, a është personi që dyshohet E.K., se ngjarja a ka ndodhur më datën 01 apo 02 të muajit gusht të vitit 2016, se si është bërë identifikimi i të akuzuarit, të gjitha këto fakte nuk janë arsyetuar dhe kanë mbetur të pavërtetuara, prandaj, aktgjykimi është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Aktakuza është ngritur në bazë të deklaratës së të dëmtuarit, kurse të akuzuarit i është mohuar e drejta që të ballafaqohet në

shqyrtim gjyqësor me të dëmtuarin edhe përkundër faktit se mbrojtja e ka kërkuar dhe këtë pas dëgjimit të dëshmitarëve të propozuar nga mbrojtja.

Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit por edhe detyrës zyrtare konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka konstatuar se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara, ka vlerësuar saktësinë e provave kundërtënëse dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e vërtetimit ekzistimit të veprës penale. Aktgjykimi është hartuar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par. 4, 7 dhe 8 të KPRK-së, është i qartë, konkret dhe i kuptueshëm, në arsyetim janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë vërtetuar drejt dhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë. Gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet në të cilat është bazuar me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, kurse pretendimet e mbrojtësit se vepra penale që i vihet në barrë të akuzuarit a është kryer me datën 1.08.2016 apo me 2.08.2016, kjo nuk është kontestues se vepra është kryer me datën 2.08.2016, por gabimisht është shënuar data 1, kurse sa i për ketë dëgjimit të dëmtuarit në shqyrtimi gjyqësor, gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes, se i dëmtuari është dëgjuar në rastin e mundësisë se hetuesisë së veçantë, konformë dispozitave të nenit 149 të KPPK-së, ku prezent kanë qenë mbrojtësi i të akuzuarit, i akuzuari dhe dëshmitari Z.A., se i dëmtuari nuk ka qenë qytetar i R. se Kosovës, andaj pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, janë të pabazuara.

Mbrojtësit të akuzuarit pretendon , se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, se me asnjë provë nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë, se i akuzuari ditën kritike ka kërkuar ryshfet, kurse gjykata e shkallës së parë vendimin e ka mbështet mbi deklaratat e të dëmtuarit të cilat kanë qenë kontradiktore, si identifikimi i të akuzuarit nga i dëmtuari është bërë në kundërshtim me dispozitën e nenit 120 të KPPK-së, kurse nga deklarata e të dëmtuarit në IPK, më dt. 02.08.2016, nuk figuron se i dëmtuari t'i ketë përshkruar tiparet dalluese të akuzuarit në këtë rast, identifikimi është bërë duke qenë vetëm i akuzuari pa prezencën e personave tjerë, nuk është mbajtur procesverbal, e sipas këtij identifikimi i akuzuari është akuzuar se gjëja ditën kritike ka kërkuar ryshfet nga i dëmtuari, kurse mbrojtja gjatë shqyrtimit gjyqësor ka kërkuar që të veçohen si prova të papranueshme dhe të mos administrohen memorandume të policisë, si dhe të dëgjohet i dëmtuari I.Xh. në shqyrtimin gjyqësor, sepse deklarata e të dëmtuarit I.Xh., është kontradiktore.

Sipas raportit policor mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit të përpiluar në stacionin policor në Malishevë, është shënuar se i dëmtuari deklaratën e ka dhënë më dt. 01.08.2016, kurse prokurori dhe gjykata pretendojnë se i akuzuari më dt. 02.08.2016 e ka kryer veprën penale, nga këto prova flasin se i dëmtuari ose ka paraqitur rastin një ditë para se me ndodhë vepra penale ose kemi të bëjmë me prova se vepra penale është kryer më dt. 01.08.2016, kurse ditën e nesërme është bërë paraqitja e kësaj vepre penale. I dëmtuari në procesverbalin në hetuesi dhe në stacionin policor i ka ndryshuar shënimet e tij personale duke mos i dhënë në asnjërën deklaratë shënimet e njëjta dhe nga këto vërtetohet i dëmtuar nuk e ka thënë të vërtetën nuk ka arritur ta identifikojë të akuzuarin, identifikimin e ka bërë në bazë të informatave që i ka dhënë policia. Konfiskimi i kartëmonedhës prej 50 €, nga i akuzuari ditën kur është marrë në pyetje nga IPK-ja, dhe administrimi i saj si provë nuk vërteton asgjë në lidhje me veprën penale, sepse ajo i takon të

akuzuarit dhe me asnjë fakt nuk vërtetohet se ajo kartëmonedhë është dhënë për ryshfet nga i dëmtuari, kurse dëshmitari Z.A., ka deklaruar se nuk i kujtohet se ditën kritike kur ka qenë së bashku me të akuzuarin E. ta kenë ndalë të dëmtuarin I.Xh., e kur është bërë identifikimi i tyre nga IPK-ja, i dëmtuari nuk i ka njohur dhe nuk ka arritur për ta bërë identifikimin i cili kishte thënë “diqysh me pas kapuqin nashta e njoh”, e dëshmitari Sh.D. ka deklaruar se më dt. 02.08.2016, ka qenë prezent kur i dëmtuari dhe zyrtarët e IPK, kanë shkuar në vendin ku kanë qenë dy zyrtar policor E.K. dhe Z.A., nuk e din se i dëmtuari ai ka njohur por ka kërkuar me i vendos kapelat, kurse dëshmitari A.G., ka deklaruar se ka qenë prezent kur është marrë në pyetje i dëmtuari dhe kur është bërë identifikimi i dy zyrtarëve policor, i dëmtuari nga distanca nuk ka mundur me i identifikuar, por me kërkesën e tij i ka thirr te dy policët janë ofruar dhe janë përshëndetur, kurse e ka pyetur të dëmtuarin se a janë këta persona për të cilët je ankuar dhe në fillim i dëmtuari nuk ishte i sigurve atëherë e ka obliguar të akuzuarin E. që të vendos kapelën në kokë, dhe ai e ka identifikuar duke thënë se po ky është, e për mbrojtja ka kërkuar nga trupi gjykues që të ftohet në shqyrtimin gjyqësor edhe i dëmtuari I.Xh., me qëllim që t’iu mundësohet palëve në procedurë që të kundërshtojnë deklarinimin e tij, ka propozuar që të mos lexohen raportet e policisë, memorandumet zyrtare, sepse të njëjtat në këtë rast nuk mund të jenë provë, gjykata e shkallës së parë, pa të drejtë i ka refuzuar propozimet e tij, i dëmtuari I.Xh., nuk ka arritur të njohë të akuzuarin dhe dëshmitarin Z.A.n, por pas bisedave me zyrtarët e policisë nga IPK-ja, nuk ka pasur zyrtar tjerë policor ka thënë më duket se ky është, gjykata faktet duhet t’i vërtetojë plotësisht e jo t’i merre të vërtetuara dilemat siç janë “më duket, mund të jetë e ndoshta ka qenë etj.”.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë, nga dëshmitë e të dëmtuarit I.Xh., të dëshmitarëve Z.A., A.G. dhe Sh.D., si dhe nga provat tjera materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor drejtë ka vërtetuar, se i akuzuari në cilësi të personit zyrtar-policit, ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, e kjo është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit I.Xh., i cili ka deklaruar se ditën kritike ka qenë duke qarkulluar me veturën e tipit “BMW” me targa RO-TV1, në magjistralen “Ibrahim Rugova” në afërsi të Prizrenit, është ndalur nga ana e policisë, për shkak të tejkalimit të shpejtësisë, me pretekst se në atë vend shpejtësia ka qenë e lejuar 100 km/h, kurse ky ka lëvizur në një shpejtësi prej 163 km/h, pas ndaljes i ka prezantuar dokumentet policit E.K., të cilat ia ka dhënë përmes dritares së veturës, por policia e ka ftuar të dalë nga vetura dhe të shkojë në drejtim të automjetit zyrtar, është ulur në vendin e pasagjerit, i ka thënë “ke qenë shpejt pse po ngutesh” të cilit i është përgjigjur se është lodhur dhe donë me mbërrë sa më shpejt në shtëpi, ka kërkuar që ta shoh radarin për me ditur se sa e ka tejkaluar shpejtësinë, por polici që e ka pasur radarin në dorë me shpejtësi e ka kthyer ka makina zyrtare, kurse i akuzuari E. i ka thënë se dënimi është 95 €, pastaj, e ka pyetur policin tjetër Z.A., duke i thënë “çka me i bërë këtij qysh me bërë më lehtë” i njëjti i ka thënë ti e din qysh janë dënimet, pastaj i është drejtuar se dënimi më i lehtë është 60 €, kurse ky është përgjigjur se nuk është problem, por duhet me shkuar në post, e posta është e mbyllur, e ka pyetur se a e njeh ti Prizrenin, kur i dëmtuari është përgjigjur se asnjëherë nuk ka qenë në Prizren, atëherë ai i ka thënë se të hollat mund t’i paguash në dorë, mundesh me i dhënë deri në 500 €, edhe njëherë e ka pyetur se sa duhet, atëherë i ka thënë se 50 €, i është përgjigjur policit se nuk dua të bëjë korrupsion dhe nuk ti japë, polici i ka thënë se duhet të pres 4 orë derisa të përfundon aksioni, atëherë i ka nxjerrë 50 €, polici para se me i marrë të hollat është ulur

“gulac” që të mos e sheh dikush, të hollat me shpejtësi i ka futur në xhep, aty afër se ka pasur edhe një veturë tjetër, kurse polici tjetër që ka qenë së bashku me te është i sigurve që nuk e ka dëgjuar bisedën, sepse ka qenë i zënë në autorstradë me radar, i ka thënë të akuzuarit “se kurrë halla nuk ta bëjë”, nuk ka mundur ta shoh ID, në uniformën e policit sepse ka pasur jelek përmbi, nuk ka mundur të regjistrojë numrat e automjetit zyrtar, sepse i akuzuari E. i kishte thënë “ec shkelja për Serbi”, por nga pasqyra e veturës kishte identifikuar vetëm nr.14 dhe 0. Për këtë i dëmtuari e ka lajmëruar rastin në stacionin policor në Malishevë, një zyrtar policor i ka thënë që të shkojnë në drejtim të Prizrenit dhe t’i takojnë policët në vendin ku e kishin ndal, kanë hyrë në rrugën e autostradës për të treguar vendin e ndaljes, por nuk i kanë gjetur zyrtarët policor në atë vend, zyrtari i policisë ka pyetur se ku gjendet patrulla e cila ka qenë e stacionuar në vendin ku ka aluduar i dëmtuari se është ndalur, pasi që polici Q.B., ka marrë informacione se vetura ka lëvizur dhe ka shkuar në dalje të Pejës, kanë shkuar në atë drejtim dhe aty nuk i kanë gjetur, Qerimi e ka thirrë me telefon policin A.G.n, kanë shkuar në një pompë të benzinës, polici A.G. e ka pyetur se a janë ata dy policët të cilët kanë qenë duke ngrënë, menjëherë nuk ka mundur me bërë identifikimin e policëve por njëri nga policët e ka identifikuar në bazë të dhëmbëve, sepse dhëmbët e përparmë i ka pasur të mëdhenjtë dhe ai ka qenë Z.A., kurse për personin tjetër E.K.n, i cili nuk ka pasur kapelën në kokë, ka thënë që të vendos kapelën në kokë me qëllim që ti epet mundësia të e identifikojë, i cili nuk e ka vendosur menjëherë kapelën në kokë, por kur ka filluar të bisedojë atëherë të njëjtin në bazë të zërit e ka identifikuar, kur është pyetur nga ana e policëve që kanë qenë prezent, se a janë këtë policët që të kanë takuar, i njëjti është përgjigjur se po, por njëjtë ka deklaruar edhe në stacionin policor në Fushë Kosovë para njësitit të hetimeve.

Kurse nga dëshmia e dëshmitarit Z.A., i cili ditën kritike ka qenë së bashku me të akuzuarin E.K., është vërtetuar se ai ditën kritike ka qenë në patrullë me të akuzuarin E., me të njëjtin kanë patrulluar në autostradën Ibrahim Rugova, kanë qenë prezent në pikën e kontrollit në kilometrin e dhjetë në drejtim të Vermicë-Prishtinë, ku edhe kanë ndalur automjete të ndryshme, se janë takuar me inspektorin e IPK në një pompë të benzinës ku ka qenë edhe i dëmtuari të cilin në fillim nuk e ka njohur. Ndërsa nga dëshmia e dëshmitarëve të propozuar nga ana e mbrojtjes se të akuzuarit A.G. dhe Sh.D., që të dy polic, të cilët ditën kritike kanë qenë së bashku me të dëmtuarin Ismet dhe me një zyrtar të IPK, në pompën e benzinës, ku kishin qenë duke ngrënë i akuzuari E.K. dhe dëshmitari Z.A., nga oborri i lokalit nuk ka mundur me i identifikuar policin E.K. dhe Z.A., sepse kanë qenë 20 m larg, i kanë ftuar ata që të ofrohen, i dëmtuari Ismet e ka identifikuar menjëherë policin Z.A. duke thënë se ka ky ka qenë në pikën e kontrollit në vendin e ngjarjes me radar, gjithashtu e ka identifikuar edhe të akuzuarin E.K., të cilin e kanë obliguar që të vendos kapelën në kokë, pastaj ka thënë se po ky është, nga është vërtetuar se kanë qenë prezent kur i dëmtuari I.Xh., i ka identifikuar të akuzuarin E. dhe dëshmitarin Zbulim i cili kishte qenë së bashku në pikën e ndaljes se të dëmtuarit Ismet .

Nga memorandumi zyrtar i dt. 02.08.2016, është vërtetuar se në stacionin policor në Malishevë, i dëmtuari I.Xh., e ka paraqitur rastin duke thënë se është ndalur nga një patrollë e policisë dhe arsyeja e ndaljes ka qenë tejkalim i shpejtësisë, i cili edhe pse ka kërkuar që t’i tregohet radari, se sa ka qenë tejkalimi i shpejtësisë, zyrtarët policor kishin refuzuar dhe nga i dëmtuari i akuzuari E.K., kishte kërkuar 50 € në të kundërtën do ti shkruhej tiketa dhe do t’i konfiskohen dokumentet. I dëmtuari gjatë dhënies se dëshmisë, kishte kishte bërë përshkrimin e personave të cilët kishin qenë në pikën kontrolluese, njërin prej tyre e kishte përshkruar si të

plotë rreth moshës 40-50 vjeç, nofullën e epërme dhe dhëmbët më të dalur jashtë ,kurse personin tjerë më të dobët zeshkan dhe rreth moshë 40 vjeç .

Kjo gjykatë konstaton se nga të gjitha provat e administruara, si dhe nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe të akuzuarit, është vërtetuar se më dt. 02.08.2016, e jo me datën 1.08.2016 siç është shënuar gabimisht në raportin e policisë në Malishevë, derisa i dëmtuari I.Xh. ishte duke udhëtuar në autorstardën “Ibrahim Rugova “ në drejtim të Prishtinës, me veturën e tipit “BMW” me targa RO-TV1, është ndalur nga një patrullë e policisë në të cilën patrullë ka qenë dëshmitari Z.A., duke bërë matjen me radar, kurse i akuzuari E.K., duke bërë ndaljen e veturave, e ka ndalur të dëmtuarin I., e ka njoftuar për arsyet e ndaljes së tij, duke i thënë se shpejtësi është lejuar në 100 km/h, kurse ju keni drejtuar automjetin në shpejtësi prej 163 km/h, se për këtë kundërvajtje duhet ti shqiptohet dënim prej 95 €, por unë po ta lehtësojë dhe po ta bëjë 60 €, të cilin duhet me paguar në postë, të njëjtin e pyet se a e njeh Prizrenin, pasi i dëmtuari thotë se nuk e njoh Prizrenin, i akuzuari thotë mi jep 50 € dhe vazhdo, duke e kushtëzuar me marrjen e dokumenteve dhe duke i thënë se lëndën do ta dërgojë në gjykatë dhe pret disa ditë me çka do të kushtojë edhe më shumë. Nga këto rrethana i dëmtuari është detyruar që të jap 50 €, pastaj ka vazhduar rrugën deri në Malishevë, ku në stacionin policor në Malishevë, e lajmëron rastin, kurse stacionin policor në Malishevë i njofton për rastin zyrtarët e Inspektoriatit policor të Kosovës, të cilët së bashkë shkojnë në vendin ku është ndalur nga policia i dëmtuari, nuk i gjejnë policët në atë vend, nga kolegët tjerë të IPK-së, njoftohen se te dy policët që kanë qenë në pikën kontrolluese ku e kanë ndalur të dëmtuarin, gjenden në pompën e benzinës “AL Petrol”, të cilët shkojnë dhe takohen me të akuzuarin dhe kolegun e tij, ku i dëmtuari se pari e identifikon dëshmitarin Z.A., si person që është marrë me rastin e kontrollit të rrugës me radar, e gjatë bisedës nga zëri dhe pasi që e vendos kapelën në kokë, e identifikon të akuzuarin E.K. që ia kishte marrë 50 €.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se i dëmtuari ka qenë kontradiktor edhe sa i për ketë dhënies se shënimeve personale të tij, nuk qëndrojnë, se nga fotodokumentacioni personal i tij, vërtetohet se është i lindur në Vrajë, kurse jeton në fshatin Samojlic. Komuna e Bujanovcit. Nga arsyet që u thanë më lartë, kjo gjykatë gjen se nuk janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se në aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, se i dëmtuari nuk e ka njohur të akuzuarin, nuk ka qenë as banor i Kosovës, por sjelljet e të akuzuarit e kanë detyruar që të lajmëroj rastin në polici edhe pse siç ka thënë i lodhur nga rruga, por nuk ka mund të pajtohet me një veprim të një personi zyrtar, se nuk e ka njohur më parë të akuzuarin.

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, i mbështetur në gjendjen faktike të vërtetuar gabimisht dhe si i tillë është përfshirë edhe me shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, se i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale marrje e ryshfetit nga neni 428 par. 2 të KPK-s, por nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer këtë vepër penale.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, gjënë se ankesa mbrojtësit të akuzuarit është e bazuar vetëm sa i për ketë shkeljes se ligji penal në dëm të akuzuarit, kur gjykata e shkalles e pare të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale nga neni 428 par. 2 të KPK-s, se nga vlerësimi i shkresave të lëndës, kjo gjykatë ka gjetur se në veprimet e te akuzuarit formohen elementet e

veprës penale nga 428 par. 1 të KPK-s, se i akuzuari në cilësi të personit zyrtar në kuadër të autorizimeve të tij, ka kërkuar të holla, në mënyrë që mos e kryej një veprim zyrtar të cilin është dashur ta kryej, si person zyrtar, të paraqes fletëparaqitje kundërvajtës ndaj I.Xh.it, i cili ka bërë kundërvajtje në komunikacion. Prandaj për këto arsye, Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, më që gabimisht është aplikuar ligji penal në dëm të akuzuarit.

Pretendimet ankimore të Prokuroria Themelore në Prizren, se dënimi i shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë, është nën minimumin e lejuar, sipas nenit 76 par. 1.3 të KPRK-së kjo gjykatë nuk i shqyrtoi, pasi që ka bërë cilësimin juridik të veprës penale nga par. 2 në par.1 të nenit 428 të KPRK, ku minimumin i dënimit sipas këtij paragrafi është 6 muaj, kurse vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit, të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë.

Ndërsa mbrojtësit të akuzuarit, ka kërkuar që i akuzuari të lirohet nga akuza, në mungesë të provave, pa theksuar ndonjë rrethanë konkrete nga ato që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë.

Pretendimet e Prokurorisë se dënimi i shqiptuar është i butë dhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është i ashpër, janë të pa bazuara.

Kjo gjykatë gjënë se gjykata e shkallës së parë me rastin e përcaktimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat që kanë dikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethana lehtësuese ka marrë, sjelljen e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, rrethanat personale, është i martuar, babë i tre fëmijëve, kurse si rrethana rënduese ka marrë parasysh se kemi të bëjmë me vepër penale që lidhet me detyrën e tij zyrtare. Prokuroria në ankesë nuk thekson rrethana konkrete rënduese të cilat kishin me ndikuar në ashpërsimin e dënimit, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë nuk thekson rrethana konkrete lehtësuese të cilat kishin me ndikuar në zbutjen e dënimit, përveç atyre që janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë si rrethana lehtësuese, të cilat rrethana lehtësuese në tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë, sipas gjetjeve të kësaj gjykate, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është në proporcion me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, andaj kjo gjykatë ka bërë cilësimin juridik të veprës penale në vepër penale më të lehtë si në dispozitiv të aktgjykimit, kurse sa i për ketë masë se shqiptuar ndalimi i ushtrimit të profesionit, sipas nenit 65 par 2 të KPRK-së thuhet se gjykata mund ti ndaloj kryesit ushtrimin e funksionit administrativ publik ose në shërbimin publike, prej 1 deri në 3 vjet nëse personi është dënuar me gjobë ose me kusht, e në këtë rast i akuzuari është dënuar me dënim me gjobë, bazuar në dënimin e shqiptuar kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk është e arsyeshme të shqiptohet masa e ndalimi i ushtrimit të profesionit, ashtu që kjo gjykatë konsideron se dënimi i shqiptuar është drejtë në proporcion me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, e sipas bindjes edhe të kësaj gjykate me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK .

Gjykata e Apelit, pati parasysh edhe faktin se për veprën penale marrje e ryshfetit nga neni 428 par. 2 të KPK, për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, parashihet dënim kumulativ, pra dënim me burgim dhe me gjobë, mirëpo pasi që gjykata e shkallës së parë të akuzuarit nuk i

ka shqiptuar dënim me gjobë, kurse për këtë nuk bëhet fjalë fare në ankesën e prokurorisë, atëherë Gjykata e Apelit vetëm e konstatoi këtë shkelje të ligjit penal në dobi të akuzuarit, por pa e ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke u bazuar kështu në parimin “Reformatio in peius”, se aktgjykimi sa i për këtë sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të akuzuarit.

Nga çka u tha më lartë , u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit në bazë të nenit 403 të KPPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.355/17 i datës 21.09.2017

Procesmbajtësi,

Arta Dumani

Anëtarët e kolegjit

1.Have Haliti

2. Abdullah Ahmeti

Kryetare e kolegjit,

Driton Muharremi

